



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
(komision përgjegjës)

Tiranë më, 17.1.2024

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR
AKTIN NORMATIV NR. 8, DATË 28.12.2023 “PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE
PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR TRAJTIMIN E
UJËRAVE TË NDOTURA QË SHKARKOHEN PRANË OSE NË UJËRA LARËSE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe 86 e 88 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi aktin normativ nr.8 datë 28.12.2023 “Për marrjen e masave për monitorimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që derdhen në ujëra larëse”, në mbledhjet e tij të datës 17 janar 2024. *Mbledhja u zhvillua në platformën Online Zoom.*

Komisioni, bazuar në nenin 29, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, caktoi relator për këtë akt normativ deputetin Z. Baftjar Zeqaj.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin:

- Zonja Almira Xhembulla, Zv/Ministre e Turizmit dhe Mjedisit dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie Znj. Arta Dollani, Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Z. Athanas Karaja, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Derregullatore;
- Zonja Enkelejda Muça, Zv/Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Z. Klevis Jahaj, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare Ujësjiellës Kanalizime.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Akti normativ nr. 8, datë 28.12.2023 “Për marrjen e masave për monitorimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që derdhen në ujëra larëse” propozohet nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, sipas të cilit, Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

➤ *Nevoja dhe Urgjenca*

Nevoja dhe urgjenca të parashikuara në nenin 101 të Kushtetutës janë elemente përcaktuese për të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit. Akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument që mundëson përshejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

Nevoja për propozimin e këtij akti normativ ka lindur pas fluksit të madh të turistëve gjatë vitit 2023 dhe mbështetet në arsyet e mëposhtme:

- Gjatë sezonit turistik veror 2023 u konstatua nga institucionet përgjegjëse për kontrollin e mjedisit një situatë emergjente, ku ndotjet e dukshme mjedisore, shkarkimet e pakontrolluara në ujëra larëse dhe problemet me gropat septike, krijojnë një ambient të ndotur, me pasoja për shëndetin e njerëzve dhe me efekt negativ në klimën e turizmit. Ndërkohë që me rritjen e shpejtë të strukturave akomoduese në zonat bregdetare dhe rritjen e numrit të turistëve rrezikohet që këto tregues të përkeqësohen gjatë vitit 2024, nëse subjektet tregtare dhe strukturat akomoduese nuk zbatojnë kërkesat e ligjit për trajtimin e ujërave të ndotura, pasi zgjerimi i Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura ekzistuese në zonat bregdetare, në vijim ITUN, dhe ndërtimi i ITUN-eve të reja kërkon kohë që të adaptohet me rritjen e shpejtë të numrit të turistëve.
- Agjencia Europiane e Mjedisit ka vlerësuar për vitin 2023 se parametrat e cilësisë së ujërave larëse në Shqipëri, janë shumë të ulët në krahasim me shtetet e rajonit me turizëm të zhvilluar, si Greqia, Kroacia apo Italia.
- Situata e emergjencës mjedisore e krijuar drejtpërsëdrejt nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik, duke shkarkuar ujëra të ndotura të patrajuara në ujëra larëse, bën të nevojshme marrjen e masave konkrete nga këto subjekte që të kontribuojnë drejtpërsëdrejt në përmirësimin e situatës mjedisore, parandalimin e ndotjes në ujërat larëse dhe mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh nëpërmjet ndërtimit të sistemeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajuara, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Urgjenca për këtë akt normativ lidhet me synimin që subjektet të plotësojnë standardet e nevojshme për trajtimin e ujërave të ndotura, përpara fillimit të sezonit të ri turistik, kohë kur duhet të ketë përfunduar plotësimi i detyrimeve sipas këtij akti për subjektet që parashikohen në këtë akt.

Gjithashtu, procedura parlamentare është një element tjetër që ka çuar drejt ndërhyrjes nëpërmjet një akti normativ, pasi nëse do të bëhej nëpërmjet një projektligji, miratimi i tij, duke pasur në konsideratë që Kuvendi mbyll punimet rreth javës së tretë të muajit dhjetor dhe i nis rreth javës së tretë të muajit janar, do të miratohej si ligj në muajin shkurt, dhe standardet e kërkuara do të plotësoheshin në fund

të muajit maj ose fillim të muajit qershor, kur sezoni turistik ka nisur. Ndërkohë që është domosdoshmëri që standardet e nevojshme të përmbushen përpara fillimit të sezonit turistik, dhe çdo operator ka vetëm 90 ditë afat për të plotësuar këto standarde.

Për këto arsye, është vlerësuar urgjenca për miratimin e këtyre parashikimeve ligjore me anë të një akti normativ.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e aktit normativ***

Qëllimi i këtij akti normativ është përcaktimi i masave detyruese, që ndërmerren për trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet vendosjes së impiantit apo sistemit të grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat nuk i trajtojnë ujërat e ndotura, të krijuara nga veprimtaria e tyre ekonomike, dhe i shkarkojnë ato pranë ujërave larëse ose në ujëra larëse.

Trajtimi i ujërave të ndotura sipas përcaktimeve të këtij akti normativ përfshin:

- ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshme;
- ndërtimin dhe funksionimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane;
- ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotura urbane deri në kolektor;
- trajtimin dhe evadimin e llumrave dhe lëndëve të ngurta që dalin nga impiantet e trajtimit.

- *Parashikimet kryesore ligjore të propozuara në aktin normativ:*

Parashikimet kryesore që sjell ky akt normativ janë sa më poshtë:

1. *Subjektet dhe detyrimet e tyre.* Subjekt i këtij akti normativ janë të gjithë strukturat që zhvillojnë veprimtari ekonomike turistike, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajuara, sipas standardeve të parashikuara pranë ujërave larëse ose në ujërat larëse. Subjekte të këtij akti në mënyrë të detajuar janë strukturat turistike si: Agroturizëm, Bujtinë, Fjetinë, Fshat turistik tradicional, Fjetje dhe Mëngjes, Hotel, Motel, Kamping, Kompleks turistik, Njësi shërbimi, Resort, Strukturë akomoduese, sipas përkufizimit të dhëna në këtë Akt normativ. Gjithashtu, Detyrimin për të vendosur impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura e kanë edhe zhvilluesit e fshatrave turistike, sipas lejes së ndërtimit.

Subjektet e mësipërme janë të kategorizuara në tre kategori sipas ngarkesës së ndotjes që shkaktojnë në ujërat detare, liqenore dhe ujore, ku: subjektet që shkaktojnë ndotje deri në 50 PE (*njëvlerës popullsie*) janë të kategorisë së parë, ato mbi 50 PE e deri në 180 PE janë të kategorisë së dytë, ndërsa ata mbi 180 PE janë të kategorisë së tretë.

Nëpërmjet këtij Akti Normativ synohet përcaktimi i masave detyruese që do të merren në kuadër të pastrimit të ujërave të ndotura të shkaktuara nga strukturat akomoduese e fshatra turistike, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në zonat bregdetare, pranë liqeneve e lumenjve. Konkretisht,

- Subjektet e parashikuara nga ky akt normativ që zhvillojnë veprimtari ekonomike, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve kanë detyrimin që, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, të vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas rregullores teknike, të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin;
 - Subjektet e parashikuara nga ky akt normativ që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat shkarkojnë ujërat e ndotura në gropat septike, duhet të marrin masat për zëvendësimin e tyre me impiante ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas detyrimeve të përcaktuara në këtë akt normativ dhe në rregulloren teknike;
 - Subjektet e parashikuara nga ky akt normativ që janë duke zhvilluar ose ndërtuar objekte akomoduese në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, janë të detyruar të bëjnë vendosjen e impiantit ose sistemeve individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas detyrimeve të përcaktuara në këtë akt normativ;
 - Subjektet që duhet të ndërtojnë impiantin e trajtimit, sipas këtij akti normativ, duhet të pajisen me deklaratë paraprake punimesh, sipas ligjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe të kryejnë “njoftimin për fillimin e punimeve” pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.
2. *Ngritja e një task force.* Akti normativ, me qëllim përmbushjen e monitorimit dhe inspektimit të përmbushjes së parashikimeve të tij, parashikon ngritjen e një task force e cila do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një periudhë 1 vjeçare.

Kjo task force do të jetë në varësi të titullarit të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve. Struktura parashikohet të jetë 49 persona, ku 38 prej tyre janë inspektorë dhe do të miratohet me urdhër të Kryeministrit. Funksionimi i saj do të mbështetet financiarisht nga buxheti i shtetit.

Kjo taskë forcë sipas aktit normativ ka për detyrë:

- Kontrollin në terren për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktin normativ, nga subjektet përkatëse, qoftë për ndërtimin e impianteve të reja të trajtimit të ujërave të ndotura, qoftë në rastet e zëvendësimit të gropave septike me impiante të trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mbledhjen e informacionit dhe krijimin e një databaze për të dhënat e të gjitha subjekteve që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe shkarkojnë ujëra të ndotura të trajtuara dhe të patrajtuara pranë ose në ujërat larëse;
- Ushtrimin e kontrolleve për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, pranë ose në ujëra larëse;
- Marrjen e masave administrative në rastet kur konstatohen shkeljet, sipas këtij akti normativ;

- Përgatitjen, në fund të muajit tetor të një raporti për punën e bërë deri në tetor 2024 në lidhje me subjektet, për të cilat është marrë masa administrative, sipas këtij akti normativ, dhe propozimin organeve përgjegjëse për heqjen e licencës, të lejes ose të autorizimit për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj subjekteve që nuk kanë plotësuar standardet edhe pas vendosjes së masave administrative.

Për kryerjen e kësaj detyre Task-Forca bashkëpunon me inspektoratet apo strukturat përkatëse që mbulojnë fushën e mbrojtjes së mjedisit, organin që ka licencuar veprimtarinë, inspektoratin sanitar ose inspektoratin bashkiak, si dhe rast pas rasti, edhe me Policinë e Shtetit.

3. Rregullorja për përcaktimin e standardeve sipas të cilave do të ndërtohen impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.
4. Përcaktimi i masave administrative. Task-Forca, pas kryerjes së monitorimit dhe inspektimit, kur konstaton mosvendosjen e impiantit apo sistemit individual në përputhje me rregullat teknike për trajtimin e ujërave të ndotura nga subjektet, merr masat administrative. Masat administrative përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor. Në rast mospagimi subjektet nuk marrin certifikatën e përdorimit për objektin ose projektin e ndërtuar apo të zhvilluar. Kur pas afatit 60 ditor, konstatohet mosplotësimi i standardeve nga subjektet e dënuara, Task Forca dënon me gjobë, me vlerë dyfishin e masës së vendosur ndaj subjektit përkatës herën e parë.

Me përfundimin e sezonit turistik, sipas njoftimit nga ministria përgjegjëse për turizmin, Task-Forca i propozon institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave për heqjen e licencës, lejes ose autorizimit, për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ndaj të gjitha subjekteve, të cilat nuk kanë plotësuar standardet për trajtimin e ujërave të ndotura edhe pas marrjes së masës administrative.

Në rastin e subjekteve ndërtuese të fshatrave turistike i propozon institucioneve përgjegjëse ndjekjen e procedurës për përjashtimin e zhvilluesit nga e drejta për të marrë leje zhvillimi ose ndërtimi për 5 (pesë) vjet, sipas parashikimeve në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, të ndryshuar.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal akti normativ përbëhet nga 12 nene dhe 1 Aneks.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky akt normativ nuk synon përafrim me ndonjë akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

- ***Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm***

Objektivat e këtij akti normativ janë rritja e përqindjes së trajtimit të ujërave të ndotura në vend, si dhe përmirësimi i ujërave larës në dete, liqene e lumenj si pasojë e trajtimit të ujërave të ndotura që derdhen pranë tyre ose në to. Këto objektiva janë pjesë e objektivave të Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, pavarësisht se relacioni shoqërues i aktit normativ nuk shprehet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Agjendë.

- ***Konsultimi publik***

Gjatë diskutimeve të këtij projektakti Komisioni nuk zhvilloi konsultime me grupe interesi.

- ***Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e projektaktit***

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve përkatëse për kryerjen e plotësimeve të standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky akt normativ sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit të cilat lidhen kryesisht me funksionimin e Task Forcës, strukturë e cila parashikohet të përbëhet nga 49 persona ku pjesën dërmuese e zënë inspektorët që do të jenë 38 persona.

Ky buxhet parashikohet në vlerën e rreth 324 milionë lekësh, të cilat do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Ky fond është i detajuar në dy zëra kryesorë që janë shpenzimet kapitale në vlerën 129.5 milionë lekë dhe në shpenzime operative në vlerën 194.5 milionë lekësh ku pjesën kryesore zënë shpenzimet për paga.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit, Z. Zeqaj u shpreh se sapo është mbyllur një vit i suksesshëm në fushën e turizmit dhe qeveria shqiptare, përmes këtij akti normativ, synon të ndërhyjë në infrastrukturën e ujërave të ndotura në rastet e konstatuara si problematike gjatë vitit 2023. Nëpërmjet këtij akti normativ synohet përcaktimi i masave detyruese, ku një masë e rëndësishme është që brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ të vendosen impiantet ose sistemet individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura sipas rregullores teknike të miratuar.

Pasi shpjegoi disa nga parashikimet e aktit normativ, relatori i propozoi Komisionit votimin e tij, meqenëse shumë shpejt do jetë edhe hapja e sezonit turistik, i cili shpresohet të jetë më i suksesshëm se ai i vitit 2023.

Zëvendësministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj. Enkelejda Muça u shpreh se ky akt është shumë i rëndësishëm dhe ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të ujërave të ndotura, e cila ka nevojë për masa konkrete e urgjente për t'u ndërmarrë nga të gjithë operatorët të cilët operojnë në tregun e shërbimeve dhe të infrastrukturave që gjenerojnë ujëra të ndotura, që kanë destinacion të fundit ujërat larëse, duke cenuar standardet minimale dhe më të rëndësishme të shëndetit publik, të interesit publik, por edhe të funksionimit të një sektori, siç është ai i turizmit në Shqipëri, që ka provuar gjithnjë e më shumë të jetë një nga sektorët dhe promotorët e rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të vendit.

Konstatimi, që ka ardhur nga organet dhe institucionet inspektuese, i një problematike që lidhet qoftë me mungesat e ndërtimit dhe funksionimit të këtyre sistemeve të kanalizimeve, qoftë me mungesat e ndërtimit dhe funksionimit të impianteve, qoftë me mungesat e trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta që dalin nga këto trajtime apo dhe shkarkimet e pakontrolluara në mjedisin pritës, ka konfirmuar probleme të karakterit strukturor të infrastrukturës së trajtimit të ujërave të ndotura. Duke pasur parasysh nevojën imediate që ka sektori i turizmit dhe infrastruktura përkatëse për t'iu përgjigjur objektivave kryesore të qeverisë në lidhje me zhvillimin e turizmit, pra me zhvillimin e një prej shtyllave të sektorit të ekonomisë në Shqipëri, dhe nevojës që të gjitha strukturat akomoduese t'u përgjigjen në kohë të gjitha këtyre kërkesave që do të vendosen përpara tyre me këtë akt normativ, sidomos për sa i përket afatit kohor brenda të cilit ata duhet të kenë siguruar përmbushjen e të gjitha këtyre detyrimeve ligjore dhe mbi të gjitha përmbushjen e standardeve teknike për ndërtimin e të gjitha infrastrukturave të përmendura më sipër, bën të nevojshëm ndërhyrjen me këtë akt normativ.

Gjatë diskutimit në komision deputetët shprehën shqetësimin se problematika e ujërave të ndotura ka 30 vjet që vijon. Bumi turistik ishte shumë pozitiv dhe ngritja e kësaj task force një domosdoshmëri, duke shpresuar kjo e fundit të jetë më shumë e orientuar për të sensibilizuar dhe për të realizuar përmirësimin e situatës se sa në aplikimin e masave administrative.

Znj. Muça sqaroi se detyrimet që i ngarkohen subjekteve të parashikuara në këtë akt janë interes publik dhe janë në interes të mjedisit, shëndetit të njerëzve, si dhe të biznesit ku përfshihen edhe vetë këto subjekte.

Në lidhje me këtë shqetësim Z. Jahja sqaroi se të gjitha subjektet, të cilat ushtrojnë një aktivitet të caktuar, e kanë detyrim nga ligji nr. 9115/2003 në fuqi, të bëjnë trajtimin e ujërave të ndotura. Duke parë shqetësimet dhe faktin që ligjet ose institucionet përkatëse mund të krijojnë situata të ndryshme, u ndërmor ky akt normativ për ta detajuar më shumë, me fokus tek njësitë akomoduese ose ato që ushtrojnë aktivitet jo vetëm pranë zonave të ujërave larëse, por edhe të kategorisë së subjektit. Për këtë arsye, nga eksperiencia që kishim nga kontrollat e ushtruara gjatë vitit 2023, kur ishin një sërë institucioneve dhe mund të krijoheshin hapësira për abuzime dhe moskorrektësi, u krijua kjo task forcë. Edhe rregullorja teknike e përgatitur është bërë e tillë që të shmangen të gjitha rastet e abuzimit.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Z. Klevis Jahja u shpreh se në këto zona ekziston rrjeti i kanalizimeve dhe impianteve por rritja e kapaciteteve akomoduese dhe prodhimi i ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga këto subjekte akomoduese e vënë në vështirësi atë pasi janë parashikuar për një numër popullsie të caktuar në bazë të zhvillimit dhe rritja ose ndryshimi i teknologjisë së tyre ishte parashikuar të bëhej pas vitit 2027.

Parashikimet e këtij akti janë për të vendosur një standard për subjektet të cilat përdorin gropa septike ose teknologji të vjetra për këtë proces, të cilat nuk i mbulojnë nevojat që ka mjedisi.

Deputetët shprehën shqetësim edhe në lidhje me infrastrukturën ekzistuese dhe përmirësimin e saj në mënyrë që t'i përgjigjet kushteve dhe ngarkesave të reja të cilat vijnë si rezultat i zhvillimit të turizmit. Shqetësime u ngritën edhe për zgjidhjet teknike të mundshme për zhvillimin e ITUN-ve në zona ku ka një kaos ndërtimor dhe duket teknikisht e pamundur ngritja e tyre.

Në adresim të këtij shqetësimi Z. Klavis Jahja sqaroi se aktualisht, në nivel kombëtar janë në funksion 10 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. Këto janë kryesisht në zonat bregdetare dhe në zonat me dendësi dhe zhvillim ekonomik. Janë në proces 4 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, ku mund të përmendim ato të Beratit dhe të Shkodrës, që mund të fillojë punën brenda vitit 2024. Gjithashtu janë në fazë projektimi impiantet për zonën e Dhërmiut e të Jalës dhe në vazhdimësi të gjitha proceset e tjera.

Më tej ai sqaroi se nëpërmjet mbështetjes me donatorët, me Ambasadën suedeze dhe me të gjithë partnerët e tjerë, aktualisht ka një plan të detajuar të të gjitha nevojave që duhen në territorin e Shqipërisë, qoftë në raport me impiantet, qoftë në raport me rrjetin e kanalizimeve, qoftë në raport me shtrirjen e kolektorit për disiplinimin e tyre. Në bazë të masterplanit të detajuar për infrastrukturën, në Shqipëri nevojiten rreth 114 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, që së bashku me rrjetin e të tjera kanë një vlerë investimi prej rreth 2,5 miliardë euro, vlerësuar nga ekspertët ndërkombëtarë dhe përgjegjësit e fushës dhe koha e implementimit të tyre do të merrte 5 deri në 7 vjet. Vazhdimësia e investimeve dhe plani duhet të ndërthuret me rregullimin edhe të detyrimeve që kanë subjektet dhe institucionet për të arritur ato norma të caktuara të trajtimit ose të nivelit të shkarkimeve.

Një tjetër shqetësim që u ngrit në komision ishte edhe ai kapaciteteve të bizneseve, që detyrohen që brenda brenda 90 ditëve të mund të akomodojnë në të gjithë territorin dhe të ndërtojnë kaq shumë impiante që kërkohen për një periudhë të shkurtër.

Z. Jahja shpjegoi se afati i lënë, prej 90 ditësh, është shoqëruar edhe me disa lehtësira në marrjen e lejeve, duke u bërë me deklarata paraprake për pajisjen dhe ndërtimin e këtyre impianteve. Subjekti nuk do të shkojë të marrë një leje ndërtimore, por, sipas parashikimeve ligjore, që është në dispozitat e fundit të aktit, është parashikuar një mundësi fleksibiliteti, ku ai do të bëjë një deklaratë paraprake bashkëngjitur me dokumentacionin që duhet për të filluar punimin. Nga studimi i bërë në tregun lokal,

rajonal dhe atë ndërkombëtar ekzistojnë kapacitetet për të mbuluar këtë lloj nevojë që mund të ketë tregu për këto impiante kompakte me kullim aktiv të trajtimit të ujërave të ndotura.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi se parashikimet dhe afatet e këtij akti normativ do të kontribuojnë në një klimë më të mirë për sektorin e turizmit për vitin 2024, në zgjidhje përfundimtare të trajtimit të ujërave të ndotura e si rrjedhojë të ujërave larës në të gjithë vijën bregdetare, si dhe në ato të liqeneve e të lumenjve.

Komisioni e miratoi aktin normativ me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Baftjar ZEQAJ

Arben PËLLUMBI

Relator

Kryetar